




Organizata
Ndërkombëtare
e Punës

HAPAT E ILO-IPEC PËR **ELIMINIMIN** E FORMAVE MË TË RËNDA TË **PUNËS** SË **FËMIJËVE** NË KOSOVË

(siç është definuar me Rezolutën e Këshillit të Sigurisë të KB 1244)



Ekipi i Përkrahjes
Teknike për Punë të
Mirëfilltë dhe Zyrja
Vendore për Europën
Qendrore dhe Lindore

Programi
Ndërkombëtar
për Eliminimin e
Punës së Fëmijëve

HAPAT E ILO-IPEC PËR **ELIMINIMIN** E FORMAVE MË TË RËNDA TË **PUNËS SË FËMIJËVE** NË KOSOVË

(siç është definuar me Rezolutën e Këshillit të Sigurisë të KB 1244)

ILO Ekipi i Përkrahjes Teknike për Punë të Mirëfillët dhe Zyrja
Vendore për Europën Qëndrore dhe Lindore

Programi Ndërkombëtar për Eliminimin e Punës së Fëmijëve

Copyright © Organizata Ndërkombëtare e Punës 2011
Publikuar së pari në 2011

Shtypur në Prishtinë
Design dhe Layout, Rrota

PUNA E FËMIJËVE NË KOSOVË¹

Varfëria, barrierat në arsim (barrierat në qasje, kushtueshmëria, kualiteti dhe relevanca) si dhe qëndrimi tolerant ndaj punës së fëmijëve detyrojnë shumë fëmijë të përfshihen në punë që në moshën 10 vjeçare. Për më tepër, “vakuumi i përkohshëm i vlerave” ka ndikuar që të thyhen vlerat e familjes dhe komunitetit, gjë që si rrjedhojë ka rritur cenueshmërinë e fëmijëve. Rrugët janë bërë vendi kryesor për socializimin e shumë fëmijëve për shkak të mungesës së përkujdesjes dhe mbikqyrjes së duhur.

Të dhënat statistikore janë të pakta, por puna e fëmijëve në Kosovë është mjaft e përhapur. Sipas të dhënave të vitit 2007², 45 përqind e popullatës në Kosovë është e varfër³, derisa 15 përqind e popullatës jetojnë në varfëri të skajshme⁴, që do të thotë se u mungojnë kushtet elementare për jetë. Ndërkohë Raporti për Vlerësimin e Varfërisë i Bankës Botërore i vitit 2005 vlerëson se varfëria nuk i prek njësoj fëmijët e grup moshave të ndryshme. Varfëria e skajshme prek 17.3 përqind të fëmijëve të moshës parashkolllore dhe 19.6 përqind të fëmijëve të moshës nga 6-14 vjeçare (moshë e cila i përket shkollimit të obliguar).

Nga prindërit që jetojnë në varfëri, puna e fëmijëve nuk shihet si pengesë për zhvillimin e fëmijës. Sektorët kryesor në të cilët paraqitet puna e fëmijëve në Kosovë janë: puna në rrugë, puna e rrezikshme në bujqësi dhe pylltari, puna në gjermimin dhe shfrytëzimin e pasurive natyrore, trafikimi i fëmijëve për punë dhe shfrytëzim seksual, shfrytëzimi i fëmijëve për aktivitete joligjore.

KORNIZA LIGJORE MBI PUNËN E FËMIJËVE

Kushtetuta e Kosovës përmban dispozita në lidhje me të drejtën e fëmijëve për mbrojtje dhe përkujdesje të nevojshme për mirëqenien e tyre, përfshirë të drejtën për mbrojtje nga dhuna, keqtrajtimi dhe eksploatimi.

Ligji i punës (Nr. 03/L-212) përcakton moshën pesëmbëdhjetë (15) vjeçare si moshë minimale për punësim. Marrëdhënia e punës me një person ndërmjet moshës pesëmbëdhjetë (15) dhe tetëmbëdhjetë (18) vjeçare mund të vendoset për punë të lehta të cilat nuk paraqesin rrezik për shëndetin dhe zhvillimin e tij/saj.

Kodi penal (Ligji Nr. 03/L-002) përcakton veprat penale të kryera ndaj një fëmiju për procesin gjyqësor ndaj të rriturve përfshirë mospërmbylljen e obligimeve familjare, mundësimin e prostitucionit, keqtrajtimin e fëmijëve në pornografi, shfrytëzimin e fëmijëve në konflikte të armatosura, shfrytëzimin e fëmijëve për aktivitete joligjore, vendosjen e kushteve të skllavërisë apo kushteve të ngjashme me skllavërinë dhe punën e detyruar.

Udhëzimi Administrativ për Parandalimin dhe Ndalimin e Menjëhershëm të Formave të Rrezikshme të Punës së Fëmijëve (17/2008) përfshin sektorët e rrezikshëm dhe aktivitetet e përgjithshme të rrezikshme që të ndalohen si çështje me prioritet në Kosovë.

¹ Siç është definuar me Rezolutën e Këshillit të Sigurisë të KB 1244, tani e tutje Kosovë

² Vlerësimi i Varfërisë, Banka Botërore dhe ESK, tetor 2007

³ Jetojnë me më pak se 1.42 Euro në ditë për person

⁴ Jetojnë nën nivelin e varfërisë së skajshme, me më pak se 0.93 Euro në ditë për person

KORNIZA INSTITUCIONALE MBI PUNËN E FËMIJËVE

Që nga viti 2004, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) ka dëshmuar zotimin e saj për adresimin e çështjes së punës së fëmijëve përmes veprimeve të mëposhtme:

- Nënshkrimi i Memorandumit të Mirëkuptimit për zbatimin e Programit Ndërkombëtar të ILO-së për Eliminimin e Punës së Fëmijëve (IPEC) nga ana e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së dhe Ministrit të Punës dhe Mirëqenies Sociale, në vitin 2005;
- Themelimi i Njesisë për Punën e Fëmijëve në MPMS në mars të vitit 2005;
- Themelimi i Komitetit të Kosovës për Parandalimin dhe Eliminimin e Punës së Fëmijëve (KKPEPF) me Vendimin e Kryeministrit të Kosovës Nr. 5 / 166, të datës 13 dhjetor 2005;
- Ofrimi i mbështetjes institucionale dhe sigurimi i pjesëmarrjes aktive të institucioneve publike si në nivelin qendror ashtu edhe atë lokal në testimin e intervenimeve të ndryshme për adresimin e çështjes së punës së fëmijëve, mbështetur nga ILO-IPEC, gjatë periudhës 2004-2009;
- Nisja e procesit për themelimin e Sistemit për Monitorimin e Punës së Fëmijëve, në pajtueshmëri me nenin 5 të Konventës së ILO-së nr. 182, për të shërbyer si bazë për formalizimin e procedurave standarde të veprimit për:
 - identifikimin, tërheqjen, mbështetjen dhe mbrojtjen e fëmijëve të përfshirë në format më të rënda të punës së fëmijëve,
 - dokumentimin e trendeve të punës së fëmijëve në sektorë specifik ekonomik
 - vlerësimin e efikasitetit të ndërhyrjeve ekzistuese në nivele qendrore dhe lokale, duke përfshirë rekomandimet dhe udhëzimet për veprime konkrete dhe zhvillimin e politikave.
- Hartimi i Planit të Veprimit për Parandalimin dhe Eliminimin e Formave më të Rënda të Punës së Fëmijëve (2011-2013), për të përcaktuar synime me afat kohor dhe për të siguruar dëshmi të qarta për zotimin e autoriteteve publike sa i përket përgjegjësive dhe ndarjes së buxhetit për realizimin e planit.



Takimi i parë i Grupit Teknik Punues për hartimin e Strategjisë për Parandalimin dhe Eliminimin e Punës së Fëmijëve (2011-2016)

ILO IPEC NË KOSOVË

Në vitin 2004, ILO dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale lansoi Programin për Eliminimin e Punës së Fëmijëve (IPEC) në Kosovë. Që atëherë, ILO-IPEC ka siguruar mbështetje teknike dhe financiare për autoritetet, partnerët social dhe shoqërinë civile për t'i eliminuar format më të rënda të punës së fëmijëve në kuadër të kornizës së programit nën-regjional, **Projekti i Asistencës Teknike kundër Punës dhe Shfrytëzimit Seksual të Fëmijëve, duke përfshirë edhe trafikimin, në shtetet e Europës Qendrore dhe Lindore (PROTECT CEE)**. Nën ombrellën e këtij programi, projektet nën-regjionale në vijim janë realizuar në Kosovë:

- “Luftimi i Punës së Fëmijëve në shtetet e zgjedhura të Paktit të Stabilitetit: Ngritja e Kapacitetit dhe Veprimi i Drejtpërdrejtë - Programi Nën-Regjional me fokus në Format më të Rënda të Punës së Fëmijëve (tetor 2003-qershor 2008, financuar nga Qeveria Gjermane)
- “Trafikimi dhe Format tjera më të Rënda të Punës së Fëmijëve në Evropën Qendrore dhe Lindore (Faza II)” (tetor 2006-dhjetor 2009, financuar nga Departamenti Amerikan i Punës).
- “Mbështetja e aktiviteteve për ngritje të politikave për Luftimin e Punës së Fëmijëve në Evropën Qendrore dhe Lindore” (janar-dhjetor 2010, financuar nga Qeveria Gjermane)

Gjatë periudhës prill 2009-qershor 2010, ILO-IPEC ka realizuar edhe projektin e **Llogarisë Plotësuese të Buxhetit të Rregullt të ILO-së në Kosovë (RBSA)**, financuar nga Qeveria Italiane. Në kuadër të këtij projekti, ILO-IPEC e ka mbështetur procesin e hartimit të Planit Kosovar të Veprimit (KAP) për Parandalimin dhe Eliminimin e Formave më të Rënda të Punës së Fëmijëve, të ndjeshëm në çështjet gjinore, duke u bazuar në konsultimet me aksionarët kyç. Për më tepër, ILO-IPEC ka punuar për fuqizimin e autoriteteve publike, sindikatave dhe organizatave të punëtorëve me njohjen e fortë të konventave themelore të ILO-së, përfshirë punën e fëmijëve dhe ka e ka ngritur kapacitetin për të marrë pjesë në formulimin dhe implementimin e Planit Kosovar të Veprimit, mobilizimin e resurseve dhe aktivitete për ngritjen e vetëdijes mbi parimet fundamentale të ILO-së dhe të drejtat në punë përfshirë edhe parandalimin dhe eliminimin e punës së fëmijëve.

Projekti aktual i ILO-së në Kosovë (janar-dhjetor 2011) financohet nga **Llogaria Plotësuese e Buxhetit të Rregullt të ILO-së (RBSA)** dhe synon mbështetjen e procesit të zbatimit të Planit Kosovar të Veprimit (KAP) për Parandalimin dhe Eliminimin e Formave më të Rënda të Punës së Fëmijëve, në radhë të parë përmes ngritjes së kapacitetit të aksionarëve kyç në nivelin qendror dhe atë lokal për adresimin e çështjeve që kanë të bëjnë me punën e fëmijëve.

STRATEGJIA E ILO IPEC

Kombinimi i intervenimeve në nivel të politikave për sigurimin e një mjedisi të favorshëm për eliminimin e formave më të rënda të punës së fëmijëve me intervenime të orientuara në ofrimin e shërbimeve në nivel të komunitetit për fëmijët dhe familjet e tyre.

Shtyllat kryesore të intervenimit të IPEC

1. Përfshirja e punës së fëmijëve në kornizat ligjore dhe të politikave
2. Ngritja e bazës së dijes mbi Format më të Rënda të Punës së Fëmijëve
3. Ngritja e kapacitetit të zyrtarëve qeveritar, organizatave të punëdhënësve dhe të punëtorëve, OJQ-ve
4. Aktivitetet vetëdijësuese
5. Zbatimi i Sistemeve të Monitorimit të Punës së Fëmijëve (SMPF) për të identifikuar fëmijët në punë dhe fëmijët që janë të rrezikuar nga përfshirja në punë, për t'i referuar ata në shërbimet përkatëse dhe për të përcjellur nëse ata i kanë alternativat e nevojshme
6. Ofrimi i shërbimeve të drejtpërdrejta për fëmijët në punë dhe fëmijët që janë të rrezikuar nga përfshirja në punë

PËRFSHIRJA E PUNËS SË FËMIJËVE NË KORNIZAT LIGJORE DHE TË POLITIKAVE

Si rezultat i punës mbështetëse të ofruar nga ILO-IPEC në Kosovë dhe partnerëve të saj, çështja e punës së fëmijëve është përfshirë në dokumentet vijuese ligjore dhe të politikave:

- **Strategjia dhe Plani i Veprimit kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore 2008-2011** (e aprovuar nga Këshilli Ministror më 31 qershor 2008). Qëllimi kryesor i këtij dokumenti është i fokusuar në parandalimin e trafikimit dhe të ri-trafikimit, mbrojtjen e viktimave dhe të dëshmitarëve, hetimin dhe përndjekjen. Mbrojtja e fëmijëve, përfshirë punën e fëmijëve, potencohet në mënyrë të posaqme si çështje e tërthortë përgjatë tërë dokumentit.
- **Strategjia dhe Plani i Veprimit për të Drejtat e Njeriut 2009-2011** (e aprovuar nga Qeveria më 3 dhjetor 2008). Puna e fëmijëve është drejtpërdrejt e adresuar në dokument në kuadër të komponentës mbi të drejtat e fëmijëve, duke u fokusuar në eliminimin e Formave më të Rënda të Punës së Fëmijëve.
- **Udhëzimi Administrativ për Parandalimin dhe Eliminimin e Menjëhershëm të Formave të Rrezikshme të Punës së Fëmijëve në Kosovë** është aprovuar nga Qeveria më 17 shtator 2008 dhe ka hyrë në fuqi më 25 shtator 2008. Ajo përfshin sektorët e rrezikshëm dhe aktivitet që ndalohen si çështje me prioritet dhe siguron procesin e rregullt të mbledhjes dhe analizës së të dhënave mbi situatën e punës së fëmijëve, duke përcaktuar rolin dhe mandatin e institucioneve të ndryshme në këtë proces.
- **Strategjia dhe Plani i Veprimit për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve 2009-2013** (e aprovuar përmes Vendimit të Qeverisë nr. 07/69 më 19 qershor 2009). Pjesa 5.1 adreson në mënyrë të veçantë mbrojtjen e fëmijëve nga format e rrezikshme të punës së fëmijëve; Pjesa 5.5 adreson parandalimin e trafikimit dhe mbrojtjen e fëmijëve viktimë të trafikimit dhe Objektivi 6 adreson Drejtësinë për të Mitur.
- **Plani i Veprimit i Partneritetit Europian** (i aprovuar përmes Vendimit të Qeverisë Nr 4/78 më 13 gusht 2009). Vendosja e një baze specifike të të dhënave mbi punën e fëmijëve dhe replikimi i Sistemit për Monitorimin e Punës së Fëmijëve në mbarë Kosovën janë veprimet kryesore në kuadër të prioritetit afatshkurtër “Adoptimi dhe implementimi adekuat i legjislacionit në mënyrë që të sigurohet mbrojtja ligjore e fëmijëve”.

NGRITJA E BAZËS SË DIJES MBI FORMAT MË TË RËNDA TË PUNËS SË FËMIJËVE

- Përmbledhje mbi Monitorimin e Punës së Fëmijëve (e përkthyer dhe botuar në shqip dhe serbisht), 2005.
- Udhëzues për Inspektorë të Punës mbi Monitorimin e Punës së Fëmijëve (e përkthyer dhe e botuar në shqip dhe serbisht), 2005.
- Doracak për Gazetar të rinj mbi Punën e Fëmijëve (anglisht, shqip dhe serbisht), 2006
- Dokument përmbledhës mbi Punën e Rrezikshme të Fëmijëve në Kosovë (anglisht, shqip dhe serbisht), 2006.
- Përmbledhje nga broshurat e ACTRAV “Sindikatat dhe Puna e Fëmijëve” (shqip dhe serbisht), 2009.
- Përmbledhje nga broshurat e ACT/EMP “Punëdhënësit dhe Puna e Fëmijëve” (shqip dhe serbisht), 2009.
- Profili i Sistemit të Sigurisë Sociale në Kosovë (përbrenda konotacionit të Rezolutës 1244 të KSKB), (anglisht, shqip dhe serbisht), 2010.
- Raport mbi analizën e legjislacionit dhe politikave (planeve të veprimit dhe strategjive) mbi punën e fëmijëve dhe punësimin e të rinjve në Kosovë (anglisht, shqip dhe serbisht), 2010.
- Broshura: “Si të parandalohen dhe eliminohen format më të këqija të punës së fëmijëve: Çfarë mund të bëjnë sindikatat?” (shqip, anglisht dhe serbisht), 2010.
- Broshura: “Si të parandalohen dhe eliminohen format më të këqija të punës së fëmijëve: Çfarë mund të bëjnë punëdhënësit?” (shqip, anglisht dhe serbisht), 2010.



Lindita Boshtrakaj © ILO

Seminari dyditor me degët komunale të Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK)

NGRITJA E KAPACITETIT TË ZYRTARËVE QEVERITAR, ORGANIZATAVE TË PUNËTORËVE DHE TË PUNËDHËNËSVE, OJQ-VE

Zyrtarë qeveritar, përfshirë përfaqësues të Zyrës së Kryeministrit-Zyrës për Qeverisje të Mirë, Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit, Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Ministrisë së Shëndetësisë, Institutit të Shëndetit Publik, Institutit të Mjekësisë së Punës janë trajnuar për adresimin e duhur të çështjeve që kanë të bëjnë me punën e fëmijëve.

Mësimdhënësit, nëpunësit e shërbimeve sociale, inspektorët e punës, inspektorët e bujqësisë, policia dhe organizatat e shoqërisë civile janë trajnuar mbi punën e fëmijëve sepse ata janë të parët të cilët mund të ndihmojnë fëmijët e rrezikuar apo fëmijët viktime të punës së fëmijëve dhe familjet e tyre.

Përfaqësues të sindikatave dhe organizatave të punëdhënësve, përfshirë Bashkimin e Sindikatave të Pavarura të Kosovës, Sindikatën e Bashkuar të Arsimit Shkencës dhe Kulturës, Odën Ekonomike të Kosovës, Aleancën Kosovare të Biznesit dhe Odën Ekonomike Amerikane janë trajnuar mbi punën e fëmijëve dhe kanë marrë pjesë në fushata vetëdijësuese kundër formave më të rënda të punës së fëmijëve.



Lindita Boshtrakaj © ILO

Tryezë e rrumbullakët me punëdhënësit e organizuar nga Oda Ekonomike e Kosovës

AKTIVITETET VETËDIJËSUESE

Disa aktivitete vetëdijsuese janë organizuar për të tërhequr vëmendjen në faktin se puna e fëmijëve paraqet rrezik dhe është e dëmshme për zhvillimin mental, fizik, social dhe moral të fëmijëve. Përqëndrimi kryesor i këtyre aktiviteteve ishte 12 qershori, Dita Botërore Kundër Punës së Fëmijëve, që shënohet çdo vit me pjesëmarrje aktive të fëmijëve, sindikatave, organizatave të punëdhënësve dhe shoqërisë civile. Ngjarjet më të rëndësishme përfshijnë:

- **Një film dokumentar mbi Format më të Rënda të Punës së Fëmijëve në Kosovë** i prodhuar në vitin 2007
- **Një njoftim publik (45 sekonda)** që u transmetua disa herë brenda ditës gjatë muajit qershor 2007 nga RTK-ja televizioni publik . Njoftimi përfshinë disa imazhe të fëmijëve që kryejnë aktivitete të punëve të rrezikshme në bujqësi dhe mesazhi i transmetuar është “Le t’i japim fund punëve të rrezikshme në bujqësi....së bashku mund t’ia dalim”.
- **Një shfaqje teatrale mbi punën e fëmijëve (me fokus në punën e vajzave)** u përgatit në vitin 2009 nga OJQ ARTPOLIS për të ngritur vetëdijen mbi punën e fëmijëve në Kosovë dhe për të inkurajuar pjesëmarrjen e të rinjve në promovimin e të drejtave të fëmijëve. Shfaqja është dhënë në Prishtinë, Obiliq, Gjilan, Mitrovicë, Drenas dhe Prizren me pjesëmarrje të **800 fëmijëve, mësuesve, prindërve dhe përfaqësuesve të Drejtorateve Komunale të Arsimit**.
- **Një ekspozitë e fotografive** të fëmijëve të përfshirë në punë të fëmijëve në Kosovë, realizuar nga një fotograf profesional është prezantuar gjatë evenimentit të fund-vitit 2008 organizuar nga Oda Ekonomike Amerikane e Kosovës me pjesëmarrjen e 80 përfaqësuesve të komunitetit të biznesit dhe organizatave tjera partnere.
- **140 fëmijë kanë marshuar në Prishtinë në vitin 2010 me mesazhet “Arrije qëllimin: Jepi fund punës së fëmijëve” dhe “Karton i kuq punës së fëmijëve”**. Marshi filloi nga ndërtesa e televizionit kombëtar RTK, ku fëmijët u takuan me Drejtorin e përgjithshëm për të diskutuar shqetësimet e tyre në lidhje me situatën e punës së fëmijëve në Kosovë dhe rolin e mediave në ngritjen e vetëdijes së opinionit të gjerë mbi çështjet e punës së fëmijëve. Marshi është organizuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.
- **150 fëmijë në rrezik dhe fëmijë të përfshirë në forma të rënda të punës nga 5 shkolla fillore në Prishtinë, Gjilan dhe Prizren morën pjesë në lojëra të futbollit dhe aktivitete tjera sportive jashtë orëve shkollore të organizuara gjatë periudhës 31 maj-11 qershor 2010 (6 aktivitete për një shkollë) të organizuara për shënimin e Ditës Botërore kundër Punës së Fëmijëve. Një aktivitet i fundit me moton “Arrije qëllimin: Jepi fund punës së fëmijëve” u organizua me 12 qershor 2010 me pjesëmarrjen e 178 fëmijëve në një stadium futbollit në Prishtinë.**





Lindita Boshtrakaj © ILO

ZBATIMI I SISTEMIT TË MONITORIMIT TË PUNËS SË FËMIJËVE (SMPF)

Sistemi i Monitorimit të Punës së Fëmijëve (SMPF) synon:

- Identifikimin e fëmijëve në punë dhe vlerësimin e rreziqeve të cilave u ekspozohen;
- Referimin e fëmijëve në punë në shërbime për rehabilitim dhe/ose ofrimin e masave të mbrojtjes nga rreziqet si qasje e përkohshme;
- Përcjelljen e fëmijëve për të verifikuar se a janë larguar nga vendi i punës dhe/ose a janë eliminuar rreziqet dhe a kanë ata qasje në shërbimet e nevojshme.

Sistemi i Monitorimit të Punës së Fëmijëve në Kosovë ka kontribuar në përfshirjen e çështjeve të punës së fëmijëve në sistemet e qeverisjes duke institucionalizuar procesin e identifikimit dhe largimit të vajzave dhe djemve nga format më të rënda të punës së fëmijëve.

Arritjet kryesore në themelimin e Sistemit të Monitorimit të Punës së Fëmijëve (SMPF) në Kosovë përfshijnë me sa vijon:

- Korniza institucionale e MPF në nivel qendror, përfshirë Grupin Teknik Punues mbi Monitorimin e Punës së Fëmijëve i mandatuar për të përkrahur vendosjen dhe funksionimin e strukturave lokale të MPF është e themeluar me vendimin të Komitetit Kosovar për Parandalimin dhe Eliminimin e Punës së Fëmijëve në mars të vitit 2007;
- Një Grup Themelor i trajnerëve, përfshirë përfaqësues nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Departamenti i Drejtësisë, Sindikata e Bashkuar për Arsim dhe Shkencë dhe OJQ-të janë trajnuar mbi SMPF dhe janë certifikuar nga ILO-IPEC dhe MPMS për të mbajtur trajnime me kolegët e tyre dhe me institucione tjera relevante që janë aktive në adresimin e situatës së punës së fëmijëve;
- Profili Kosovar i MPF është miratuar nga Komiteti për Parandalimin dhe Eliminimin e Punës së Fëmijëve dhe ofron bazë për themelimin e Komiteteve Lokale të Veprimit në mbarë Kosovën bazuar në mësimet e nxjerra nga faza pilotuese;
- Udhëzuesi për trajner mbi zhvillimin e proceseve të Sistemit të MPF është në dispozicion;
- Format për Menaxhimin e Rasteve dhe MPF janë standardizuar nga MPMS për t'u shfrytëzuar nga QPS-të në mbarë Kosovën;

- Puna e fëmijëve është përfshirë si një kategori e veçantë në bazën qendrore të të dhënave të MPMS-së nga marsi i vitit 2008;
- Një proces i Menaxhimit të Rasteve për fëmijët e tërhequr nga puna është testuar në gjashtë komuna të Kosovës;
- Korniza institucionale në nivel lokal duke përfshirë Komitetet Lokale të Veprimit mbi SMPF për të a/koordinuar aktivitetet e MPF, b/ rishikuar të dhënat e konsoliduara për punën e fëmijëve nga Qendrat për Punë Sociale, c/përgatitur planet vjetore të veprimit për adresimin e punës së fëmijëve në nivel komunal dhe d/ofruar rekomandime mbi veprimet e mëtejme për përforcimin e reagimit lokal ndaj punës së fëmijëve që janë testuarr gjatë periudhës 2005-2009 në gjashtë komuna.
- Një Raport me rekomandime për duplikimin e Sistemit MPF në mbarë Kosovën duke u bazuar në intervistat e bëra me anëtarët e KLV-ve dhe me partnerët implementues në gjashtë komunat e testuara mbi ndikimin, sfidat dhe rekomandimet e MPF është aprovuar nga Komiteti Kosovar për Parandalimin dhe Eliminimin e Punës së Fëmijëve në takimin e datës 13 tetor, 2009.
- Një plan pune për duplikimin e Sistemit MPF në mbarë Kosovën përgatitur nga Instituti i Politikave Sociale në konsultime me Grupin Teknik Punues mbi MPF dhe ILO IPEC, në përputhshmëri me raportin me rekomandime të miratuar nga Komiteti
- Si vazhdimësi e përkrahjes së ILO IPEC për themelimin e sistemit të MPF në Kosovë, duplikimi i Sistemit të Monitorimit të Punës së Fëmijëve është përfshirë si prioritet i Institutit të Politikave Sociale në Planin e Veprimit të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) për 2010. Gjatë vitit 2010, Instituti për Politika Sociale-MPMS ka realizuar takime të nivelit të lartë me Kryetarët e Asambleve Komunale të 25 komunave të reja (Viti, Kaçanik, Shtime, Suharekë, Lipjan, Pejë, Malishevë, Klinë, Fushë Kosovë, Skenderaj, Vushtrri, Mamushë, Rahovec, Junik, Deçan, Podujevë, Han i Elezit, Klllokot, Istog, Gjakovë, Kamenicë, Ranillug, Novobërd dhe Graçanicë). Marrëveshjet formale për vendosjen e SMPF KLV në 25 komunat e lartpërmendura janë nënshkruar ndërmjet Institutit për Politika Sociale- Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Kryetarëve të Komunave.

OFRIMI I SHËRBIMEVE TË DREJTPËRDREJTA PËR FËMIJËT NË PUNË DHE FËMIJËT E RREZIKUAR

Shumë fëmijë të rrezikuar për t'u përfshirë në punë apo fëmijë të përfshirë në Format më të Rënda të Punës së Fëmijëve kanë pranuar përkrahje të drejtpërdrejtë në kornizën e programeve të IPEC-ut. Fëmijët kanë pranuar shërbime edukative dhe të tjera, përfshirë: inkuadrimin në sistemin arsimor, mësim të përshtetshëm, mësim plotësues, orientim në karrierë, arsim jo-formal, mentorim dhe përkrahje për përmirësimin e performancës në shkollë, trajnim profesional, trajnim në kompani, punësim për fëmijët që kanë arritur moshën ligjore të punësimit, përkrahje me materiale (rroba, libra dhe material shkollor, shërbime të transportit dhe komplete të mjeteve/pajisjeve për kurse të trajnimeve profesionale, etj.).

Për më tepër, anëtarët e familjeve të fëmijëve në punë janë refruar në Zyrat e Punësimit dhe u janë ofruar seanca të orientimit në karrierë, trajnime profesionale, punësim dhe mjete/pajisje pune për të përkrahur vetpunësimin, si dhe seanca këshilluese mbi rreziqet që ndërlidhen me punën e fëmijëve në rrugë dhe në bujqësi.



Edona Berisha-Kida © ILO



Edona Berisha-Kida © ILO

PLANET E MËTEJME

Ndërlidhja ndërmjet Punës së Fëmijëve dhe Punësimit të të Rinjëve

Përderisa puna e fëmijëve është e papranueshme dhe duhet të eliminohet, neglizhimi i potencialit të të rinjëve është një humbje ekonomike dhe sociale të cilën ekonomitë nuk mund t'ia lejojnë vetes. Nëse nuk adresohet në mënyrën e duhur, ndikimi i krizës në fëmijë dhe të rinj mund të rrezikojë kapitalin njerëzor të vendeve dhe mund të gjenerojë pasoja afatgjata të ekonomive në regionin tonë.

Veprimet efektive ndaj punës së fëmijëve dhe punësimit të të rinjëve duhen bazuar në njohjen e plotë të ndërlidhjes mes tyre. Prandaj nevojitet një perspektivë e integruar për zhvillimin e strategjive adekuate. Duke pasur parasysh se kalimi i lehtë nga shkolla në punë fillon me përgatitjen e duhur për tregun e punës, strategjitë për përmirësimin e gjasave të të rinjëve duhen plotësuar me përpjekjet për eliminimin e punës së fëmijëve dhe për përmirësimin e perspektivave për punësimin e të rriturve.

Ndërlidhja ndërmjet Punës së Fëmijëve dhe Mbrojtjes Sociale

Krahas strategjive të gjera për zhvillim ekonomik dhe social, një çelës i rëndësishëm për adresimin e varfërisë është vendosja apo përforsimi i mbrojtjes sociale, duke u siguruar ndihmën e nevojshme atyre që u nevojitet. Sigurimi i një mbrojtjeje sociale më të fokusuar ndaj mirëqenies së fëmijëve mundëson përfitim më të madh jo vetëm për fëmijët, por edhe për familjet e tyre, komunitetin dhe zhvillimin kombëtar në përgjithësi.

Bazuar në Iniciativën e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtje Sociale që synon të sigurojë qasje ndaj shërbimeve sociale dhe transfereve sociale për të varfërit dhe popullatën e rrezikuar, është shumë e rëndësishme që të ekzistojë një ndërlidhje më e mirë ndërmjet mbrojtjes sociale dhe politikave që kanë për qëllim eliminimin e punës së fëmijëve. "Ndërtimi i blloqeve" për një mbrojtje sociale mund të përfshijë masa siç janë: programet e transferit të mjeteve, shërbimet dhe transferet që kanë të bëjnë me përkujdesjen e fëmijëve, programet për sigurimin e ushqimit, grantet shkollore, programet për sigurimin e ushqimit në shkolla dhe programet tjera të asistencës sociale.



**ILO Ekipi i Përkrahjes Teknike për Punë të Mirëfillët
dhe Zyrja Vendore për Europën Qendrore dhe Lindore**

**Programi Ndërkombëtar për
Elimininin e Punës së Fëmijëve**

**www.ilo.org/budapest
www.ilo.org/ipecc**